

LIGJ
Nr. 50/2024

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË AKTIN NORMATIV, ME FUQINË E
LIGJIT, NR. 4, DATË 9.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PRIVATIZIMIN
DHE DHËNIEN NË PËRDORIM SHOQËRIVE TREGTARE DHE
INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE APO OBJEKTEVE TË
VEÇANTA, MJETEVE KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË KËTYRE
NDËRMARRJEVE”, MIRATUAR ME LIGJIN NR. 9967, DATË 24.7.2008, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me nismën e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në aktin normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënie në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Paragrafi i dytë i nenit 2 ndryshohet si më poshtë:

“Kalimi i pronës shtetërore në pronë private bëhet nëpërmjet formave të ndryshme të privatizimit, si: shitjes me ankand, ose tjetërsimit, sipas veprimeve juridike të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të përcaktuara në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, përveç formës së kalimit të pronësisë nëpërmjet kontratës së dhurimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Prona shtetërore mund të shkëmbehet me pasuri private nga ministrinë, institucionet e tjera qendrore, në varësi të Kryeministrit dhe të ministrive, organet e vetëqeverisjes vendore, që kanë në pronësi ose përdorim pronë shtetërore, si dhe ndërmarrjet ose shoqëritë tregtare shtetërore. Kriteret për vlerësimin e pronave që privatizohen apo shkëmbehen, si dhe procedurat e format e privatizimit, mënyrat e shkëmbimit të pronës shtetërore, si dhe rastet përjashtimore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) fjalët “në Ministrinë e Financave” zëvendësohen me fjalët “në ministrinë përgjegjëse për ekonominë”.

b) pas fjalisë së parë shtohet fjalia e dytë me këtë përmbajtje:

“Këshilli i Ministrave përcakton me vendim procedurat, kohën, mënyrat dhe garancitë që ministria përgjegjëse për ekonominë parashikon në kontratën e shitjes së pronës shtetërore, përfshirë edhe rastet e parashikuara në legjislacionin përkatës për dhënie me qira apo privatizimin e pronës shtetërore për turizëm apo qëllime të tjera.”

Neni 3

Pas nenit 5 shtohet neni 5/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 5/1

Shembja e objekteve në funksion të zhvillimit

Kur pasuria shtetërore që përmban objekte apo ndërtesa shtrihet në gjurmën e projekteve për të cilat është miratuar leja e zhvillimit në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, objektet dhe ndërtesat ekzistuese të ndodhura në këtë pasuri shemben në funksion të zhvillimit të projektit në përputhje me procedurat e parashikuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Shpenzimet e shembjes, si dhe vlera kontabël e këtyre objekteve apo ndërtesave, përballohen nga subjekti zhvillues i projektit. Përcaktimi i vlerës kontabël sipas këtij neni bëhet nga ekspert/ë kontabël të emëruar për këtë qëllim nga ministri përgjegjës për ekonominë.”

Neni 4
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 16.5.2024.